

VENDIM
Nr. 548, datë 27.7.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, ME SHKËMBIM
NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PROJEKTIN “EU4SCHOOLS”,
FAZA E DYTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4schools”, faza e dytë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

Nr. 3068/prot.

Tiranë, më 06.06.2022

DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

Në vijim të shkresës Tuaj Ares(2021) 7877474, datë 20.12.2021, në lidhje me Projektin e financuar nga Bashkimi Evropian për programin "EU4Schools", faza e II, me përmbajtjen si më poshtë:

Faza e dytë e mbështetjes së BE-së për rehabilitimin dhe rindërtimin e objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti 2019, "EU4Schools", u nënshkrua me UNDP-në në Tetor 2020.

Ky kontribut i 60 milion Euro, është pjesë e premtimit financiar të dhënë në Shkurt 2020 në Konferencën e Donatorëve, "Together for Albania" dhe përmbush mbështetjen e dhënë në Qershor 2020 në fazën e parë, e cila është në zbatim. Në total 63 objekte arsimore do të mbështeten nga Programi "EU4Schools", 22 në fazën e parë dhe 41 në fazën e dytë, me një kontribut total prej 75 milion Euro.

Bazuar në punimet përgatitore dhe negociatat e bëra ndërmjet Delegacionit të BE-së dhe UNDP-së, bashkëlidhur gjeni listën me 41 objektet arsimore të propozuara për tu përfshirë në fazën e dytë të Programit "EU4Schools".

Në qoftëse do të jetë e nevojshme, lista mund të përshtatet, bazuar në zhvillimet teknike të zbatimit si edhe në rezultatet e prokurimeve. Në këto rrethana, do të ishim të gatshëm të konsultonim me ju modifikimet e mundshme, në mënyrë që të arrijmë një dakordësi nga Qeveria Shqiptare.

Do të isha mirënjohës nëse mund të rishikonit dhe miratonit listën e propozuar në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit.

Jemi besimplotë në mbështetjen tuaj për të siguruar angazhimin e nevojshëm të institucioneve përkatëse vendore dhe kombëtare, për një zbatim efektiv dhe të suksesshëm të këtij partneriteti midis BE-së dhe PNUD-it, në të mirë të popullit shqiptar.

Lista totale e objekteve arsimore pjesë e Programit EU4Schools (Faza e dytë) dhe tipologjia e ndërhyrjeve

	Objekti Arsimor	Tipi	Bashkia	Tipologjia e ndërhyrjes
1	Varosh	Kopsht	Bashkia Krujë	Ndërtim
2	Shkollë Bilaj	9- vjeçare+Kopsht	Bashkia Krujë	Ndërtim
3	Gjergj Kastrioti	9- vjeçare	Bashkia Lezhë	Ndërtim
4	Fran Ivanaj	9- vjeçare+kopsht	Bashkia Lezhë	Rikonstruksion
5	Naim Frashëri	Shkollë e mesme	Bashkia Durrës	Ndërtim
6	Gjergj Kastrioti	Shkollë e mesme	Bashkia Durrës	Ndërtim
7	Olsi Lasko	Shkollë e mesme	Bashkia Durrës	Ndërtim
8	Eftali Koci	9- vjeçare+ kopsht	Bashkia Durrës	Ndërtim
9	Nr.3	Çerdhe	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
10	Kopshti Bizë	Kopsht	Bashkia Durrës	Ndërtim
11	Bernardina Qerraxhi	Shkollë e mesme profesionale	Bashkia Durrës	Ndërtim
12	Bernardina Qerraxhi	Konvikt	Bashkia Durrës	Ndërtim
13	Shkolla Karpen	9- vjeçare	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
14	3 Deshmorët	9-vjeçare	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
15	Charles Telford Erickson	Shkollë e mesme profesionale	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
16	Cerdhe Babrru	Çerdhe	Bashkia Kamëz	Ndërtim
17	Azem Hajdari	Kopsht	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion
18	Jashar Hoxha	Kopsht	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion
19	Ibrahim Basha	Kopsht	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion
20	Kryevidh	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Rrogozhinë	Ndërtim
21	Rreth-Greth	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Rrogozhinë	Ndërtim
22	Xhorxh Sorros	9-vjeçare	Bashkia Rrogozhinë	Rikonstruksion
23	Okshtun	Kopsht	Bashkia Rrogozhinë	Ndërtim
24	Vilë Bashtovë	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Rrogozhinë	Ndërtim

25	Bërxaullë	9-vjeçare	Bashkia Vorë	Ndërtim
26	Vorë	9-vjeçare	Bashkia Vorë	Ndërtim
27	Kopshti Nr. 41	Kopsht	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
28	Musine Kokalari	9-vjeçare+ Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim dhe Rikonstruksion
29	26 Nëntori	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
30	Emin Duraku	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim
31	Xhezmi Delli	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim
32	Asim Vokshi	Shkollë profesionale	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
33	Kopshti Nr. 1	Kopsht	Bashkia Kurbin	Ndërtim
34	Kopsht & Cerdhe Rubik	Kopsht+Çerdhe	Bashkia Mirditë	Ndërtim
35	Kopshti Nr. 2	Kopsht	Bashkia Shijak	Ndërtim
36	Rilindja	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Shijak	Ndërtim
37	Beqir Çela	Konvikt	Bashkia Durrës	Ndërtim
38	14 Nëntori	9-vjeçare+Kopsht	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
39	Myslym Keta	Shkolla e Mesme	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
40	Cerdhe Nr. 2	Çerdhe	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
41	Kopshti Manzë	Kopsht	Bashkia Durrës	Ndërtim

Këshilli i Ministrave shprehet në parim dakord ne lidhje me :


1. Projekti do të zbatohet në koordinim të plotë me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë (përfshirë Komisionin Shtetëror për Rindërtim).
2. Procesi i prokurimit dhe zbatimi i projektit do të ekzekutohet nga UNDP në përputhje me standardet shqiptare dhe standardet e Bashkimit Evropian.
3. Mbikëqyrja e punimeve do të realizohet nga UNDP dhe do të merret në dorëzim nga bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin, Kamëz, Kavajë.
4. Të gjitha detyrimet ligjore dhe detyrimet ndaj palëve të treta në sheshet e ndërtimit mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente, përkatësisht bashkive.
5. Bashkitë respektive do të marrin përsipër të garantojnë vendosjen në dispozicion të donatorit (Kontribuesit) të sheshit të ndërtimit. Nëse ka probleme me zonimin dhe pronësinë, do të zgjidhen nga autoritetet kompetente.

6. Bashkitë respektive do të marrin përsipër t'i garantojnë vendosjen në dispozicion të donatorit (Kontribuesit) të gjithë dokumentacionin e nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për kryerjen e punimeve.
7. Granti që siguron burimet për projektin i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore në fuqi për përjashtimet përkatëse fiskale, në rast të fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Nota Juaj së bashku me këtë notë përbëjnë marrëveshjen me shkëmbim notash, e cila do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Duke Ju falenderuar,

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE
ARBEN AHMETAJ**





EUROPEAN UNION - BASHKIMI EVROPIAN

DELEGATION TO ALBANIA
DELEGACIONI NE SHQIPERI
The Head of Delegation
Kreu i Delegacionit

H.E. Mr Arben Ahmetaj
Deputy Prime Minister and
Minister of State for
Reconstruction
and Reforms' Program
Prime Minister's Office
Tirana - Albania

Tiranë, 20.12.2021

Ares(2021) 7877474

Objekti: Programi EU4Schools II (Faza e dytë)

I Nderuar Z. Zëvendëskryeministër,

Faza e dytë e mbështetjes së BE-së për rehabilitimin dhe rindërtimin e objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti 2019, "EU4Schools", u nënshkrua me UNDP-në në Tetor 2020.

Ky kontribut i 60 milion Euro, është pjesë e premtimit financiar të dhënë në Shkurt 2020 në Konferencën e Donatorëve, "Together for Albania" dhe përmbush mbështetjen e dhënë në Qershor 2020 në fazën e parë, e cila është në zbatim. Në total 63 objekte arsimore do të mbështeten nga Programi "EU4Schools", 22 në fazën e parë dhe 41 në fazën e dytë, me një kontribut total prej 75 milion Euro.

Bazuar në punimet përgatitore dhe negociatat e bëra ndërmjet Delegacionit të BE-së dhe UNDP-së, bashkëlidhur gjeni listën me 41 objektet arsimore të propozuara për tu përfshirë në fazën e dytë të Programit "EU4Schools".

Nëqoftëse do të jetë e nevojshme, lista mund të përshtatet, bazuar në zhvillimet teknike të zbatimit si edhe në rezultatet e prokurimeve. Në këto rrethana, do të ishim të gatshëm të konsultonim me ju modifikimet e mundshme, në mënyrë që të arrijmë një dakordësi nga Qeveria Shqiptare.

Do të isha mirënjohës nëse mund të rishikonit dhe miratonit listën e propozuar në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit.

Jemi besimplotë në mbështetjen tuaj për të siguruar angazhimin e nevojshëm të institucioneve përkatëse vendore dhe kombëtare, për një zbatim efektiv dhe të suksesshëm të këtij partneriteti midis BE-së dhe PNUD-it, në të mirë të popullit shqiptar.

Sinquerisht
Luigi Soreca
Ambasador

ANEKS

Lista e objekteve arsimore pjesë e Programit EU4Schools (Faza e dytë)

1.	Bashkia Durrës	NJ.A Durrës	E mesme	Naim Frashëri	Ndërtim
2.	Bashkia Durrës	NJ.A Durrës	E mesme	Gjergj Kastrioti	Ndërtim
3.	Bashkia Durrës	NJ.A Shkozë	E mesme	Olsi Lasko	Ndërtim
4.	Bashkia Durrës	NJ.A Durrës	9- vjeçare+ kopsht	Eftali Koci	Ndërtim
5.	Bashkia Durrës	NJ.A Durrës	Çerdhe	Nr.3	Rikonstruksion
6.	Bashkia Durrës	NJ.A Ishëm	Kopsht	Bizë	Ndërtim
7.	Bashkia Durrës	NJ.A Durrës	Konvikt	Bernardina Qerraxhi	Ndërtim
8.	Bashkia Durrës	NJ.A Rajoni 2	Shkollë profesionale	Bernardina Qerraxhi	Ndërtim
9.	Bashkia Krujë	NJ.A Krujë	Kopsht	Varosh	Ndërtim
10.	Bashkia Krujë	NJ.A Bubq	9- vjeçare	Bilaj	Ndërtim
11.	Bashkia Lezhë	NJ.A Lezhë	9- vjeçare	Gjergj Kastrioti	Ndërtim
12.	Bashkia Lezhë	NJ.A Ishull Shëngjin	9- vjeçare	Fran Ivanaj	Rikonstruksion
13.	Bashkia Kavajë	NJ.A Karpen	9- vjeçare	Karpen	Rikonstruksion
14.	Bashkia Kavajë	NJ.A Kavajë	9-vjecare	3 Deshmoët	Rikonstruksion
15.	Bashkia Kavajë	NJ.A Golem	Shkollë profesionale	Charles Telford Erickson	Rikonstruksion
16.	Bashkia Kamëz	Kamëz	Çerdhe	Babrru	Ndërtim
17.	Bashkia Kamëz	Paskuqan	Kopsht	Azem Hajdari	Rikonstruksion

18.	Bashkia Kamëz	Paskuqan	Kopsht	Jashar Hoxha	Rikonstruksion
19.	Bashkia Kamëz	Bulqesh	9-vjeçare	Ibrahim Basha	Rikonstruksion
20.	Bashkia Rrogozhinë	Rrogozhinë	9-vjeçare+Kopsht	Kryevidh	Ndërtim
21.	Bashkia Rrogozhinë	Rrogozhinë	9-vjeçare+Kopsht	Rreth-Greth	Ndërtim
22.	Bashkia Rrogozhinë	Rrogozhinë	9-vjeçare	Xhorxh Sorros	Rikonstruksion
23.	Bashkia Rrogozhinë	Rrogozhinë	Kopsht	Okshtun	Ndërtim
24.	Bashkia Rrogozhinë	Gosë	9-vjeçare + Kopsht	Vilë Bashtovë	Ndërtim
25.	Bashkia Vorë	Bërçullë	9-vjeçare	Bërçullë	Ndërtim
26.	Bashkia Vorë	Vorë	9-vjeçare	Vorë	Ndërtim
27.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Kopsht	Nr. 41	Rikonstruksion
28.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Kopsht+9-vjeçare	Musine Kokalari	Rindërtim + Rikonstruksion
29.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Kopsht+9-vjeçare	26 Nëntori	Rikonstruksion
30.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Kopsht+9-vjeçare	Emin Duraku	Rindërtim
31.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Kopsht+9-vjeçare	Xhezmi Delli	Rindërtim
32.	Bashkia Tiranë	Tiranë	Shkollë profesionale	Asim Vokshi	Rikonstruksion
33.	Bashkia Kurbin	Mamurras	Kopsht	Nr. 1	Rindërtim
34.	Bashkia Mirditë	Rubik	Kopsht+Çerdhe	Mirditë	Rindërtim
35.	Bashkia Shijak	Shijak	Kopsht	Nr. 2	Rindërtim
36.	Bashkia Shijak	Shijak	9-vjeçare+Kopsht	Rilindja	Rindërtim
37.	Bashkia Durrës	Nj. A Durrës	Konvikt	Beqir Çela	Rindërtim
38.	Bashkia Durrës	Nj.A Durrës	9-vjeçare+Kopsht	14 Nëntori	Rikonstruksion
39.	Bashkia Tiranë	Nj. A Tiranë	Shkolla e Mesme	Myslym Keta	Rikonstruksion
40.	Bashkia Durrës	Nj. A Durrës	Çerdhe	Nr. 2	Rikonstruksion

41	Bashkia Durrës	Nj. A Manëz	Kopshti	Manzë	Rindërtim
----	----------------	-------------	---------	-------	-----------